

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Data: 30.06.2022

Numri i vrojtimit të lejes:

07 Nr.343/350-28368

-Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit e Komunës së Suharekës në bazë të kërkesës së z. Mevludin Kuçi nga Suhareka, Komuna Suharekë, me 07 Nr.350-28368 të datës 13.05.2022 - në të cilën kërkon dhënie e lejes për shfrytëzimin e hapsirës publike, në bazë të nenit 8 alinea 8.9 të Rregullores për Tarifat, Ngarkesat dhe Gjohat nga Shërbimet dhe Veprimtarit Komunale - 01 Nr. 16-12102 të datës 01.12.2015, nenit 5 pika 5.2 al. 5.2.2, nenit 8 pika 8.3, nenit 9 al. 9.19.7, nenit 11, 12, 13 dhe 14 të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike dhe private 01-Nr.16-4719 të datës 30.06.2016, si dhe Procesverbalit 07Nr.226/350-28653 të datës 30.05.2022 bie këtë:

PËLQIM

Ky dokument lëshohet për:			
Emri:	Mevludin Hysen Kuçi	Nr. Personal	
Adresa:	Rr."Xh Bajraktari"- Suharekë.	Telefoni:	
Email :		Kërkesa Bazë:	Pëlqim-për shfrytëzim të hapsirës publike për vendosjen e disa lodrave me bateri .

Përshkrimi:

I LEJOHET - investuesit - z. **Mevludin Kuçi** nga Suhareka, Komuna Suharekë, shfrytëzimi i hapsirës publike për vendosjen e disa lodrave - vetura dhe motorra me bateri për argëtim të fëmijëve, në një sipërfaqe prej **20.00 m²**, në sheshin "Ibrahim Rugova", në rrugën "Brigada-123" në Suharekë, në parcelën kadastrale Nr.00794-1, pronë shoqërore, zona kadastrale Suharekë.

Vendosja e lodrave të cekura më lartë, si dhe shfrytëzimi i sipërfaqes së tokës shoqërore- hapsirës publike - **lejohe me karakter të përkohshëm sezonal** dhe vlen nga data **03.06.2022** deri më **31.08.2022**, me mundësi të vazhdimit pas shqyrtimit të rrethanave të reja të krijuara dhe dispozitave tjera ligjore.

Shfrytëzuesi do të shfrytëzojë hapsirën publike në një sipërfaqe prej **20.00 m²**, për të cilën do të paguaj sipas Rregullores së Komunës së Suharekës për shfrytëzimin e pasurisë - tokës shoqërore, dhe atë **3 euro për m² në muaj**, shuma për pagesë prej **03.06.2022** deri me **31.08.2022** është gjithsejtë: **176,00 Euro**.

Investuesi obligohet që sipërfaqen e cila i jepet në shfrytëzim ta mirëmbajë pastër.

Gjithashtu hapësira e cila i jepet në shfrytëzim nuk lejohe të kufizohet (rrethohet) .

Trotuari duhet të jetë i lirë dmth. shfrytëzimi i sipërfaqes së lejuar duhet të shfrytëzohet në atë mënyrë që të mos e pengon lëvizjen e lirë të qytetarëve (këmbësorëve) në trotuar.

Për nevoja më të mëdha të realizimit të planit urbanistik të asaj pjese të Suharekës, ku lejohe shfrytëzimi i kësaj hapësire për vendosjen e përkohshme të objekteve të cituara më lartë, investuesit edhe para skadimit të afatit të caktuar me këtë Pëlqim mundet të i bihet Aktvendimi për mënjanimin e objekteve në fjalë, pa kurrfarë kompensimi nga ky Organ e në shpenzime të vet investuesit.

Me rastin e festave kombëtare, tubimeve dhe për nevoja të tjera nga drejtoria e Urbanizmit - jeni të obliguar që objektet e cekura më lartë ti menjani për një kohë të caktuar.

Nëse ka ankesa nga ana e fqinjëve përshkak të zhurmës apo pengesave tjera të arsyeshme të banorëve për rreth, atëherë do të merren masa konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Për mos kryerje të punëve sipas këtij Pëlqimi, inspekcioni përkatës do të veproj sipas rregullave të parapara me ligj.

Ky Pëlqim pushon të vlej nëse investuesi nuk i vendos këto brenda afatit të cituar në këtë Pëlqim.

A r s y e t i m

Duke e shqyrtuar kërkesën e investuesit z. **Mevludin Kuçi** nga Suhareka, Komuna Suharekë, ky Organ konstatoi se kërkesa është e arsyeshme dhe se të përmendurit mundet të i lejohe vendosja e disa lodrave - vetura

dhe motorra me bateri për argëtim të fëmijëve si dhe shfrytëzimi i pasurisë - hapësirës publike, në një sipërfaqe prej **20m²** sipas skicës e cila i bashkangjitet këtij Pëlqimi dhe me afat të caktuar me këtë Pëlqim.

Kërkesës i është bashkangjitur dëshmia mbi pagesën e rregullimit të Taksës Komunale.

Kërkesës i është bashkangjitur edhe dëshmia mbi pagesën e Taksës Administrative - Pëlqimit për vendosjen e objekteve të përkohshme dhe shfrytëzim të hapësirës publike konform Rregullores mbi tarifën dhe ngarkesat 01 Nr. 16-12102 të datës 01.12.2015 - sipas nenit 8. pika 8.8.5.- në vlerë prej **15.00 euro**.

Udhëzime Juridike : Kundër këtij Pëlqimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese - MMPHI-së Prishtinë, përmes kësaj drejtorie, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të së njëjtit.

Pëlqimi i dërgohet:

-Parashtruesit të kërkesës, Inspektorit Komunal dhe dosjes së DUP-it.

Zyrtari përgjegjës:

Agron Bajraktari

Drejtori i Drejtorisë:

Visar Kuçi

